REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 284/20
Datë/Datum. 08.05.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **Komuna e Klinës**
(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)
Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **2020/634-20-328-2-1-1/B54-0002859**
(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për"**"SHERBIME TE MIREMBAJTJES HIXHENIKE TE OBJEKTEVE , MIREMBAJTJE E HAPSIRAVE PUBLIKE DHE SIGURIM FIZIK I OBJEKTEVE"**

LOT 2 - SIGURIM FIZIK TE OBJEKTEVE

(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"TFS GROUP" SH.P.K. & "LAGUNA" SH.P.K. & "KING SECURITY" SH.P.K. (Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. "Isa Kastrati" p.n. Prishtinë

(Adresa)

Prishtinë
(Vendi)
049 70 10 20
(Numri Telefonit)

(Kodi postar)
10,000
(Numri i Faks-it)

Arbon Thaqi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
tfs_group@hotmail.com
(Adresa elektronike)

06.05.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

TFS GROUP SH.P.K. Prishtinë 810070764

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën "është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës.

Njoftimi për kontratë - 26.02.2020 në faqen zyrtare të e-prokurimit. *Njoftimi për dhënie të kontratës – 27.04.2020* *Afati i fundit për dorëzim - 31.03.2020 në ora 13:30.* *Fillimi i hapjes së tenderëve – 14:00* *Kriter për dhënien e kontratës - çmimi më i ulët për OE që i plotëson kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.* *Vendim kundër kërkesës për rishryqrtim – 30.04.2020*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po				**Jo**	X

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK

lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	X			Jo	

Letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm e kemi marrë me datë 27.04.2020. Në njoftim thuhet se:

Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Tenderi i juaj është administrativisht i pa përgjegjshëm: GABIME NË LLOGARITJE MBI MASËN 2%

2 LOT 2 VLERA E LEXUAR 78.058,00 EURO , VLERA E GJETUR REALE 92.143.81€ . Ndryshimi TVSH KENI LLOGARITUR 0.00 VLERE € Gabimi ju NUK keni llogaritur TVSH 18 %

GABIMET :

Lot 2 + 14.085.81 € apo 18 %

Ju informojmë se kontrata për lot 2 i është dhënë OE: "KS A.S.S" - Prishtinë për vlerën 79,395.12 €.

Konsiderojmë se janë shkelur dispozitat ligjore të LPP-së, përkatësisht Neni 7, 56, 59, 61, 69 i Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës.

Me këtë rast Autoriteti Kontraktues me rastin e shpalljen fitues të OE "KS A.S.S" - Prishtinë për Lot 2, ka bërë shkelje të këtyre neneve, duke mos aplikuar standard të njëjta për të gjithë tenderuesit.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Konsiderojmë se me eliminimin nga aktiviteti i prokurimit, Zyra e Prokurimit në Klinë ka bërë shkelje të rëndë të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës, përkatësisht Neni 7, 56, 59, 61, 69 i Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës.

Sepse kompania jonë ka ofertuar me çmimin me të lirë dhe kemi qenë të përgjegjshëm.

Andaj, me këtë akt AK ka shkelur dispozitat ligjore të LPP-së, përkatësisht Neni 7 (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi) Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Fillimisht me datë 17.04.2020 na është dërguar një Letër Standarde për Sqarim nga Zyra e Prokurimit në Klinë, në të cilën njoftohemi për llogaritje të gabuar.

Ku njoftohemi se LOT 2 VLERA E LEXUAR 78.058,00 EURO , VLERA E GJETUR REALE 92.143.81€ . Ndryshimi TVSH KENI LLOGARITUR 0.00 VLERE € Gabimi ju NUK keni llogaritur TVSH 18 % .

Në fund te letrës na është kërkuar të kthejmë përgjigje nëse pajtohemi me këto ndryshime.

Po të njëjtën ditë i kemi kthyer përgjigjen si vijon:

Përmes këtij emaili sqarojmë se çmimet e ngarkuara ne sistemin elektronik te e-prokurimit kanë qene me TVSH, do te thotë është llogaritur totali, si dhe janë ngarkuar forma e exelit. Ne deklaratën përfundimtare të tenderit shihet se çmimi i ofruar total është i llogaritur me TVSH.
Të ngarkuar në këtë email keni edhe format në exel, ashtu siç janë llogaritur çmimet me TVSH.
Andaj, kërkojmë nga ana e Juaj qe te merrni parasysh këtë, sepse çmimet janë te llogaritura me TVSH ne te tri llotet.

Lot 1 - 89,208.00 euro
Lot 2 - 78,057.00 euro
Lot 3 - 71,366.40 euro

Përmes komunikimeve të vazhdueshme me email, me zyrtarin e prokurimit kemi dërguar edhe dëshmi, se çmimi është total me TVSH (Lot 2 - 78,057.00 euro), duke dërguar lidhjen që krijon sistemi i prokurimit, ku në faqen 6 të Formularit të Tenderit shkruan se çmimi total është 78,057.00 euro (Lot 2).

Edhe në listën e exelit të çmimeve shihet kolona e çmimit total të ofruar nga kompani jonë, dhe AK ka mundur që vetëm të llogarisë TVSH në kolonën e veçantë që ka qenë, e cila nxjerrët nga total i çmimit, e jo ta shtoj TVSH çmimit total, sepse me këtë veprim na ka nxjerrë ofertues me çmim dukshëm më të lartë, se sa çmimi i ofertuar në bazë të analizës financiare që kompania jonë ka bërë për pagesën e 7 punëtorëve sa parashihen të angazhohen në Llot 2.

Po ashtu i kemi dërguar dëshmi se në rastet e tilla që ka shqyrtuar OSHP dhe interpretimet e KRPP-se se: gabimet ne TVSH-se nuk përkufizohen gabime aritmetike dhe nuk vlen rregulli +-2% dhe si te tilla nuk mund te na shtohet TVSH.

Edhe për kundër këtyre sqarimeve dhe fakteve, zyrtari i prokurimit ka vendosur që çmimit total të na shton TVSH prej 18 % (Lot 2 + 14.085.81 €) duke na klasifikuar si tenderues me çmim dukshëm më të lartë nga konkurrentët tanë, në këtë mënyrë duke i mundësuar OE tjetër që të shpallet fitues me çmim dukshëm më të lartë se çmimi i ofertuar nga kompania jonë, në vlerë prej 79,395.12 euro, duke dëmtuar buxhetin e komunës për shumën prej 1,388.12 euro.

Konsiderojmë se me këtë veprim, Zyra e Prokurimit në Klinë ka bërë shkelje të rëndë të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës, përkatësisht Neni 7, 56, 59, 61, 69 i Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, me këtë akt janë shkelur dispozitat ligjore të LPP-së, përkatësisht Neni 7 (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi) Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Konsiderojmë se me këtë vendim është shkelë konkurrenca e lirë dhe është favorizuar në mënyrë të padrejtë kompania që është shpallë fituese.
Për pjesëmarrje në këtë tender, çdo kompani pjesëmarrëse ka shpenzime materiale, pasi qe kërkohen siguri tenderi dhe shumë dokumente tjera me pagesë.

Si përfaqësues të konzorciumit "TFS GROUP" SH.P.K. & "LAGUNA" SH.P.K. & KING SECURITY" SH.P.K. propozojmë që të merret parasysh ankesa, tenderi të kthehet në rivlerësim, të merren për bazë kriteret dhe kushtet e parapara në dosjen e tenderit dhe të shpallemi fitues, sepse kemi ofertën me të lirë të përgjegjshme.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*